




TERMOCENTRAL QË MBRON MJEDISIN

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë do të modernizohen në të ardhmen e afërt. Kjo do të ndikojë edhe në uljen e ndotjes.

Fillimisht, termocentrali "Kosova A" do të dekomisionohet, ndërsa energjia e prodhuar nga ky termocentral do të zëvendësohet me termocentralin e ri "Kosova e Re". Si rezultat emetimet në atmosferë do të reduktohen ndjeshëm.

Krahasuar me termocentralin "Kosova A", termocentrali i ri do të reduktojë emetimet e pluhurit për 93%, emetimin e oksideve të sulfurit për 85%, emetimet e azotit për 93%, si dhe do t'i ulë emetimet e dioksidit të karbonit për 38%. Këto parametra janë nën limitet e caktuara nga Bashkimi Evropian përmes Direktivës për Emetimet Industriale.

Kështu, me termocentralin "Kosova e Re" do të përmirësohet në masë të madhe cilësia e ajrit duke e sjellë kështu Kosovën një hap më përpara drejtë integritimit në Bashkimin Evropian.



sipas standardeve të Bashkimit Evropian

